



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

K R Y E T A R E

Lindita NIKOLLA

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE PËR VITIN 2022**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur AKEP-in si autoritet i pavarur në mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor;

Duke njohur situatën e re të krijuar me uljen e numrit të sipërmarrësve (operatorëve) në tregjet e telefonisë së lëvizshme nga tre në dy operatorë;

Duke theksuar rëndësinë e rritjes dhe përmirësimit të sigurisë kibernetike, mbikëqyrjen rregullatore të qëndrueshmërisë, pacenueshmërisë dhe integritetit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në vend;

Duke theksuar se nxitja e investimeve duhet të ketë në fokus zhvillimin e qëndrueshëm digjital të vendit, rritjen e cilësisë së shërbimit, garantimin e të drejtave të konsumatorëve, si dhe nxitjen e konkurrencës së ndershme dhe të lirë në treg,

Vlerëson për vitin 2022:

Punën e bërë nga AKEP-i lidhur me monitorimin e masave të marra nga operatorët për zbatimin e përcaktimeve të Rregullores 49/2021, veçanërisht për trajtimin e ankesave të pajtimtarëve, aksesin në shërbimet e emergjencës dhe përcjelljen e informacionit të vendndodhjes etj.

Punën e bërë për rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të trajtimit të ankesave të pajtimtarëve të depozituara në AKEP nëpërmjet ngritjes së Komisionit të Zgjidhjes Alternative të Mosmarrëveshjeve për trajtimin e mosmarrëveshjeve pajtimtar dhe sipërmarrës, si dhe krijimit të regjistrit elektronik të ankesave të pajtimtarëve.

Punën e bërë dhe masat e marra lidhur me respektimin e procedurave të portimit të numrit nga ana e operatorëve celularë, gjë që ka sjellë një rënie në numrin e kërkesave të refuzuara, si dhe të ankesave të pajtimtarëve për refuzim të këtyre kërkesave.

Punën e bërë në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit për ndjekjen/kontrollin e përmbushjes së detyrimeve nga ana e “Postës Shqiptare” sh.a. duke bërë të mundur heqjen e tarifimit nga

marrësi për tërheqjen e pakove postare, si dhe hapat konkretë për të përmirësuar gjendjen për ndarjen e llogarive.

Punën e bërë në lidhje me përdorimin e sistemit ATLAS duke zhvilluar trajnime me të gjitha bashkitë në vend.

Punën e bërë për nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike të Republikës së Maqedonisë së Veriut (AEK), si dhe Marrëveshjen Teknike Ndërkufitare për Harmonizimin e Frekuencave.

Punën e bërë për të garantuar akses të barabartë për personat me aftësi të kufizuara, si dhe për të garantuar ofrimin e shërbimeve sa më të dobishme për këtë kategori duke monitoruar masat e marra nga operatorët kryesorë për të zbatuar përcaktimet e Rregullores përkatëse dhe njëkohësisht duke bërë të mundur printimin e rregullores në format të printuar në sistemin shkrimor Braille dhe në version elektronik në format audio.

Punën e bërë dhe bashkëpunimin me MIE-në për ndryshimet ligjore në ligjin e komunikimeve elektronike për të bërë të mundur që këto ndryshime të jenë në përputhje me Kodin e ri Europian të Komunikimeve Elektronike dhe njëkohësisht të krijojnë një kuadër rregullator efektiv për zhvillimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të telekomunikacionit dhe në koherencë me sfidat në fushën e komunikimeve elektronike.

Masat e marra nga AKEP-i, si dhe investimet e kryera me qëllim rritjen e sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve kritike në AKEP dhe parandalimin e sulmeve kibernetike;

Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2023 i rekomandon AKEP-it:

1. Duke patur parasysh situatën e re të krijuar me vetëm dy operatorë të telefonisë celulare, t'i kushtojë një vëmendje të shtuar këtij tregu dhe në bashkëpunim të ngushtë dhe luajal edhe me Autoritetin e Konkurrencës të shmangin krijimin e një tregu oligopol në vend duke bërë të mundur zhvillimin e një konkurrence të ndershme mes operatorëve në treg.

2. Duke patur parasysh situatën e krijuar pas agresionit rus në Ukrainë, të tregojë vëmendje dhe kujdes të shtuar për sa i takon integritetin dhe pacenueshmërisë së rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike (telefoni, internet) për të parandaluar, menaxhuar dhe eliminuar çdo problematikë.

3. Të marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së në lidhje me sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave, duke krijuar një grup pune të përhershëm për mbikëqyrjen e situatës së sigurisë kibernetike për sipërmarrësit e komunikimeve elektronike që direkt ose indirekt janë të lidhur me infrastruktura kritike kombëtare, si dhe të përditësojë rregulloren përkatëse për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve të komunikimeve.

4. Të japë kontribut konkret në grupin ndërinstitucional të punës, të ngritur me urdhër të Kryeministrit, për lirin e brezit digjital divident dy (DD2). Lirimi i këtij brezi për shërbimet e lëvizshme 5G ka ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të vendit, si dhe në ofrimin e shërbimeve me shpejtësi të lartë interneti.

5. T'u përgjigjet në kohë sfidave që dalin para AKEP-it në tregun e shërbimeve postare, të cilat kanë për qëllim zbatimin e një kuadri rregullator që nxit shërbimet inovative dhe, në të njëjtën kohë, stimulon konkurrencën e ndershme, me fokus kryesor përcaktimin dhe zbatimin e rregullave të konkurrueshmërisë për të parandaluar anomalitë që rrjedhin nga abuzimi i mundshëm i tregut, si nga ana e kërkesës, ashtu edhe nga ajo e ofertës.

6. Të bashkëpunojë me AMA-n në marrjen e masave lidhur me fenomenin e ri të piraterisë online, ku vihet re një shtim i numrit të operatorëve piratë që transmetojnë nëpërmjet internetit dhe faqeve të ndryshme që ofrojnë produkte audiovizive pa autorizimin e AMA-s.

7. Të rrisë përpjekjet për harmonizimin e legjislacionit në fushën e komunikimeve elektronike. Harmonizimi i legjislacionit sjell heqjen e barrierave për një treg shërbimesh të shoqërisë së informacionit, nxitjen e konkurrencës dhe mbrojtjen e konsumatorit në këtë sektor,

si dhe nëpërmjet përdorimit të një teknologjie të shpejtësisë së lartë zgjerimin dhe maksimalizimin e mundësive për qasjen ndaj shërbimeve online.

8. Të ketë në vëmendje të veprimtarisë tij që zotërimi i të drejtave të përdorimit të frekuencave të mos pengojë, por përkundrazi të nxisë mundësitë e barabarta për të konkurruar për operatorët ekzistues, sikurse mundësinë e hyrjes në treg të operatorëve të rinj celularë, virtualë apo jo.

9. Në kuadër të detyrimeve të Rregullores 49/2021 për operatorët lidhur me aksesin në shërbimet e emergjencës, të bashkëpunojë me operatorët dhe institucionet përkatëse për të bërë të mundur që marrja e SMS-ve dhe informacionit të vendndodhjes të mundësohet edhe nga platformat e trajtimit të thirrjeve/komunikimeve të emergjencës.

10. Me gjithë përmirësimet e bëra nga “Posta Shqiptare” sh.a. në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, duhet të vijojë të kërkojë përmbushjen e detyrimit për shpërndarjen e objekteve postare në adresën e marrësit, “Posta Shqiptare” sh.a., si një problematikë e cila vijon të mbetet.

11. Të vijojë punën për realizimin në kohë të projektit “Zhvillimi i Atlasit të Broadband të Shqipërisë”, si një projekt i cili synon të rrisë transparencën në shkëmbimin e informacionit për komunikimet me brez të gjerë (broadband), të përmirësojë politikëbërjen dhe planifikimin në sektorin digjital, si dhe të stimulojë investimet në zonat ku aktualisht broadband mungon ose ka mungesë konkurrence.

12. Të marrë masa për pjesëmarrjen dhe për të dhënë kontribut konkret në tryezën në nivel teknik të inicuar nga AMA lidhur me bashkërendimin e punës midis institucioneve për gjetjen e zgjidhjeve më të mira për problematikën e sistemit të kabllave ekzistuese në shtyllat e energjisë elektrike.

13. Të kërkojë nga dy operatorët në treg që brenda një kohe sa më të shkurtër (brenda një viti) të marrin masa për mbulimin me shërbim celular të akseve rrugore të vendit, në mënyrë të veçantë të ketë në fokus akset ku qarkullimi i automjeteve është edhe më i lartë.

Miratuar në datën 20.7.2023